

8JA-1

N. BULKA

1392



20
6

191-200

Ne dritën e yllit

8P1.783-1

B92

8A-1

Bul 92.

~~11339~~

5

N. BULKA

DIV. ... - J. 112118
GJIROKASTER

11685

NE DRITEN
E YLLIT



Shtëpia Botonjese «Naim Frashëri»

Tiranë, 1952

MUJO ULQINAKU

Ç'janë ata që nxijnë detin?
Nëno! E dëgjon tërmetin?

— Jan hordhitë e dushmanit,
Që t'i vënë zjarr vatanit
O biro!

— Ç'jan ata këmishë - zesë,
Që po vinë aq serbes,
Me ca pupla si këndes
O nëna ime?

Ata janë mizorira
Që po vinë me zinxhira,
Të na lidhin këmb' e kokë,
E ta bëjnë var e gropë,
Çdo luath, çdo fush e pyll
Do nxirosinë çdo yll!
Pa do mbushin me kufoma,
Me kufoma, ah të njoma
Çdo kodrin e çdo hendek
Mal më mal! e brek më brek.
— Zjarr nga deti, zjarr nga qjelli;
Nëno u sterrua dielli!

— Durrës ty o Durrës plak,
Hasmi po të shkel në prak!
Populli u mbyt në gjak.
Çpo lëfton një ulqinak.
Lëfton djali, lëfton plaku
Gjer në gju na vate gjaku,
Bjeri Mujo Ulqinaku

Për liri.

Lëfton populli arbreshit.
Si dikur me pallë sheshit
Për Shqipri.

Thrret Guzzoni: Mamma mia,
Ç'burra paska Shqipëria!,

Telegramet venë e vinë
Nga Llonioni në Athinë
Nga Belgradi n Amerikë,
Nga Asia në Afrikë
Nga Parisi gjer në Moskë
Çpo lëftojnë geg' e toskë
Për një truall për një prak,
Rrugët lahenë me gjak!

Kush lëfton ashtu më këmbë?
Kush ha hekurin me dhëmbë?
Janë burrat shqipëtarë,
Që po heqin zorrët zvarë!,

Të trathtuar nga një mbret!
Q'u degdis për në kurbet!

Është Mujua një kapter,
Që lufton e vdes me nder!

Dhe ja plumb i mallëkuar,
Tej-përtej në kraharuar!
Ç'na u mbyt trimi në gjak,
Për një truall për një prak,
Nëna me të madhe qan,
Kur sheh shtrir' atë luan:
— Gjirin ta kam bër' hallall
Xhan o shpirt me yll në ballë!
Ti m'u vrave për liri
Ndaj të qan një Shqipëri,
Bir o bir si lumthi ti.

KUSHTRIM NGA PEZA

Çka pllakosur errësira
Vëndin tim!
Skllavëri, kamzhik zinxhira
Dhe mjerim!

Re të zeza nga çdo anë!
Tingëllon nër male, fusha,
Një këmbanë.
Tingëllon këmban e zisë
Çip më çip të Shqipërisë!
Tradhëtia po mer dhenë,
Robëria mbyt milenë,
Dhe pamporat nxijnë denë!

Ç'paska rënë hije zisë,
Çip më çip të Shqipërisë!

Vrënjtur burrat, qajnë gratë
Zhgaba hesht në mal të thatë..

— S'paska burra që t'i dalin
Zot vatanit?
S'paska trima që t'i japin grusht
Dushmanit?

Kukuvajka, sorra, korba
Fluturojnë,
Gjer në qjej të errësuar,
Dhe Shqiponja zemër hekur
Paska vdekur
Emër - shuar?....
Turp e tmerr....

*Dhe në var në fund të dheut
Lëviz trup i Skënderbeut!*

*Ndaj rënkojnë gra e motra
Ndër të zeza;..
Kur një zë buçet rrufe
Thellë nga Peza
— Mjaft me lot, mjaft me rënkime
Nëna ime!
Popull ty të qofsha falë,
Të kam at e më ke djalë!
Erdhi koha, bura gra ta bëjmë
Ta bëjmë fora,
Komunisti kur e heq
S'i shkon bosh dora!
Se e ndrrin yll i Kremlinit,
Se e prin tjal' e Stalinit.
Dhe kushtrimi mori dhenë!
Zhgaba trime la folenë!
Dhe Partia me flamur
Që mban në dorë,
Yje, yje, për rreth kokës
Një kurorë,
Përmbi male me dëborë
Ngjall një popull gjysmë vdekur,
Farkëton një zëmër hekur.*

**Dhe në varr në fund të territ
Prehen eshtrat e Skënderbeut!
Se nër qej të Shqipërisë
Po gjëmon zër' i Enverit!**

BRIGADAT

**Ç'u mbush mali me petrira
Me drangoj,
Ndaj po oshëtin përroj.
Thonë se po vjen tërmeti!
Ndaj i egër shkumzon deti!
Thonë ra rrufe nga qjelli,
Ndaj u nxi e u zu djelli!
Syrin flak e gjoksin zjarr.
Po sulmon brigad'e parë!
Dil nëno e shiko jashtë
Si flakron brigad'e gjashtë!
Dil shiko malit përpyetë,
Vetëtin brigad'e tetë!
Prej Skrapari në Berat,
Fluturon brigada shtatë.
Kërcet topi anës tjetër;
Ububu, brigada katër!
Ç'jan ato vetulla zes,**

*Ngjeshur bombat mu në bres?
Si s'e njuh brigadën pesë?
E shikon një re të zezë,
Që po zbret nga trimja Pezë,
Hapur gjoksat si asllanë,
Që sulmojnë mbi Tiranë?*

*Vërë re! u skuq Vijosa!
Po nxin mali Trebeshinës!
Pallë çveshur si fatosa
U përhap kudo si zjarri
Që nga Vlora e Skrapari,
Labëri, Shkodër, Tiranë
Korçë, Dibër, nga çdo anë,
Ajka e rinisë ranë!
— Bubu ç'varre pa kurora
Ç'po shikoj Oh unë e gjora
 Bir o bir.
Dhe mbi qiell të sterosur
Grumbuj gjeraqina sorra!
— *Bir o bir!*
Mali bardhë me dëborë
Mu mbi var u ri kurorë
Dhe mbi ballë yll u ndrit;
S'e shikon si llambarit?*

Shtrëngon dhëmbët nën e madhe

Shqipëtare

Mu si shqipe e egërsuar

Dhe krenare:

Edhe pyet e thelluar

Në mejtim,

Si e thonë kapedanë që i prin?

Mi të gjithë mu si Ylberi,

Komandant i prin Enveri.

“PARTINË MBI TE GJITHA“

Po na vjen Dhjetëvjetori!

Ç'do këndojë vjershëtori

Q'i del afsh nga krahërori?

Dhjetë vjet Parti-lavdi!

Do këndoj popullin tënë

Dje me njerjë, sot me nënë

Sot i gjallë, plot shëndet

Ngjitem gërxeve përpjetë,

Maja maljt gjer te retë:

Se atje gjej frymëzime

Ku çdo shkëmb ruan kujtime